

MONITOR: ZBATIMI I PRIORITETEVE REFORMUESE URGJENTE

Periudha: 09-20.11.2015

Zbatimi i marrëveshjes politike

Parlamenti miratoi pakon e ligjeve¹ të rëna dakord paraprakisht në seancën e mbajtur më 9 nëntor dhe solli vendimin për formimin e Komisionit anketues për skandalin e përgjimeve.

Ministrat dhe zëvendësministrat e propozuara nga LSDM dhe zëvendësministrat nga VMRO-DPMNE (të ministrave të propozuar nga LSDM-ja) u votuan në seancën parlamentare të mbajtura më 11 nëntor. Me këtë u bë një hap i rëndësishëm në drejtim të formimit të të a.q. qeveri kalimtare e cila pritet t'i organizojë zgjedhjet e prillit.² Përveç kësaj, kryeministri aktual duhet të japë dorëheqje 100 ditë para zgjedhjeve, dhe në krye të qeverisë do të zgjidhet kryeministër i ri i propozuar nga VMRO-DPMNE.

Në rendin e ditës të negociatave për zbatimin e Marrëveshjes gjendet edhe reforma në fushën e medias. Sipas raportit të progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë për vitin 2015, liria e të shprehurit si dhe gjyqësori dhe disiplinë financiare janë fusha ku është vërejtur zbrapsje. Në këtë raport Komisioni e thekson nevojën për mbarim të rishikimit të Marrëveshtjes kornizë të Ohrit, në kontekstin përmirësimit e kohezionit social.³

Dhënia e rekomandimit për nisjen e negociatave është kushtëzuar **me zbatimin e plotë të marrëveshjes politike dhe progresit thelbësor në zbatimin e prioriteteve të reformave urgjente**, me çka Komisioni do të rishqyrtojë çështjen menjëherë pas zgjedhjeve në prill. Prioritetet e reformave urgjente, në përputhje me metodologjinë e re të Komisionit Evropian në përgatitjen e raporteve, janë të listuar si rekomandime për tejkalimin e situatës kritike, sidomos në lidhje me kriteret politike dhe Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore.

Sundimi i ligjit dhe gjyqësori

Gjyqësori

Prokurorja speciale publike dërgoi një kërkesë në Prokurorinë Publike për të marrë të dhënat për numrin e rasteve të ngritura nga prokuroritë publike që kanë të bëjnë me fushëveprimin e saj të punës, caktimin e prokurorive publikë dhe numrat nën të cilat janë evidentuar. Prokuroria Publike respektoi afatin ligjor prej 8 ditësh⁴ dhe më 19 nëntor deklaroi se i kishte dorëzuar të dhënat për 35 raste.⁵ Midis tyre nuk është rasti "Puç".⁶ Prokurorja speciale më 10 nëntor u takua me kreun e Misionit të OSBE-së, Nina Suomalainen, e cila ka shprehur mbështetje.

Për shkak të mungesës së serishme të Zoran Zaevit në seancës dëgjimore të pestë të rastit "Puç" që u mbajt më 13 nëntor, për seancën e ardhshme gjykatësi urdhëroi shoqërimin e tij me polici.⁷ Qëndrimi i Zaevit që mos të shfaqet në seancën e radhës, do të mbetet i njëjtë në qoftë se deri atëherë rasti nuk i dorëzohet Prokurores speciale.⁸ Zaevi do të gjykohet edhe për rryshfetmarrje, në pajtim me vendimin e Këshillit për vlerësimin e aktakuzës të Gjykatës Themelore Shkupi 1.⁹

Rregullorja e re e Këshillit Gjyqësor të RM-së më 17 nëntor u publikua në faqen e internetit të Këshillit gjyqësor¹⁰ Kjo rregullore rregullon punën e Këshillit Gjyqësor të RM-së, zgjedhjen e anëtarëve, kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Këshillit; zgjedhjen e gjyqtarit, kryetarit të gjykatës, dhe gjyqtarit porotë; përfundimin e mandatit

¹Ligji për informatorët; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal; Ligji për ndryshimin e Ligjit për Qeverinë; Ligji për mbrojtjen e privatësisë; Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor

² Në pajtim me Marrëveshjen politike, qeveria aktuale do të paraqesë dorëheqjen e saj zyrtare në Kuvend në kohën e duhur për të lejuar inaugurimin e qeverisë së re më 15 janar 2016. 100 ditë para zgjedhjeve parlamentare që do të mbahen më 24 prill, 2016. Ministrat e rinj dhe zëvendësit e tyre do të mbeten në pozicionet e tyre në qeverinë e re

³ Faza e parë e rishikimit e MKO u realizua në vitin 2012. Faza e dytë e cila shqyrtohet me përkrahje të OSBE dhe Institutit Evropian për paqe filloi në shtator të vitit 2015. Ishin formuar gjashtë (6) grupe punuese për analizë të pjesëve të ndryshme të MKO dhe gjatë 03.11 – 20.11.2015 ishin mbajtur konsultime tematike për të gjitha gjashtë lëmitë tematike të MKO (përfaqësimi i drejtë, antidiskriminim komunitete më të vogla, decentralizim, përdorimin e gjuhëve dhe arsimit).

⁴ Neni 11 paragrafi 2 i Ligjit për Prokurorinë Publike për krime që lidhen dhe dalin nga përmbajtja e përgjimeve të paligjshme (2) Me kërkesë me shkrim nga ana e Prokurorisë Publike, prokurorët publikë janë të detyruar në afat prej tetë ditësh të dorëzojnë çdo rast me të cilin veprojnë për të vendosur nëse rasti bie nën juridiksionin e Prokurorit Publik Special, në përputhje me të drejtat e tij / saj të përcaktuara me këtë ligj.

⁵ Njoftim për shtyp. Faqja e internetit e PPRM. 19.11.2015. Në dispozicion në: <http://iorm.gov.mk/?p=2324>

⁶ Nga aktivitetet e monitorimit të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë.

⁷ Nga aktivitetet e monitorimit të Koalicionit "Të gjithë për gjykime të drejta"

⁸ Njoftim për shtyp. Faqja e internetit e LSDM-së. 12.11.2015. Në dispozicion në: <http://www.sdsrm.org.mk/default.aspx?mId=55&agId=2&articleId=12733>.

⁹ Njoftim për publikun. Faqja e internetit e Gjykatës Themelore Shkupi 1 18.11.2015 Në dispozicion në: <http://www.osskopje1.mk/Novosti.aspx?novost=429>.

¹⁰ Rregullorja e Punës së Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, miratuar më 30 tetor. Në dispozicion në:

<http://www.ssrn.mk/docs/akti/%D0%94%D0%95%D0%9B%D0%9E%D0%92%D0%9D%D0%98%D0%9A%D0%97%D0%90%D0%A0%D0%90%D0%91%D0%9E%D0%A2%D0%90%D0%9D%D0%90%D0%A1%D0%A1%D0%A0%D0%9C%2030%2010%202015.pdf>

dhe shkarkimin; vendosjen për imunitetin dhe ndalimin e gjyqtarit; vlerësimin e punës së gjyqtarit dhe kryetarit të gjykatës dhe çështje të tjera në kuadër të kompetencave të Këshillit.¹¹ Këshilli Gjyqësor më 13 nëntor u takua me anëtarët e Komisionit të Venecias në lidhje me (propozim) amendamentet e reja të legjislacionit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve¹² U diskutua legjislacioni për përgjegjësinë disiplinore, në mënyrë të veçantë krijimi i Këshillit për vërtetimin e fakteve dhe ngritja e procedurës për përgjegjësi të gjyqtarit, gjatë takimit të delegacionit të Komisionit të Venecias me përfaqësues të shoqërisë civile, që u mbajt një ditë më parë.¹³

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi në rastin Hajrullahu kundër Republikës së Maqedonisë, përcakton se shteti është përgjegjës për shkelje të nenit 3 të Konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, e cila ka të bëjë me ndalimin e torturës.¹⁴ **Byroja që përfaqëson RM-në para KEDNJ** në bashkëpunim me Akademinë për trajnim të gjyqtarëve dhe prokurorëve më 10 nëntor organizoi një seminar në lidhje me përsëritjen e procedurës gjyqimore pas aktgjykimit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Akademia për gjykatës dhe prokurorë publik publikoi shpallje për pranimin e 30 pjesëmarrësve të rinj në trajnimin fillestar që do të jenë kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë publikë.¹⁵ Më parë, me rastin e zgjedhjes të ekipit të prokurores publike special në publik u ngrit edhe çështja e mungesës së personelit në prokuroritë publike.

Përgjimi i komunikimeve

Sipas vendimit për krijimin e **Komisionit hetimor për skandalin e përgjimeve**, Komisioni duhet të përcaktojë kronologjinë e ngjarjeve dhe rrethanave dhe përgjegjësinë politike lidhur me përgjimet dhe përmbajtjen e materialeve të botuara. Komisioni hetimor duhet të përgatisë rekomandime të cilat do të synojnë për të parandaluar përgjimin e paligjshëm të komunikimeve dhe rritjen e transparencës së institucioneve shtetërore dhe qeveritare.

Kuvendi i zgjodhi anëtarët e Komisionit¹⁶ në seancën e mbajtur më 17 nëntor, me propozimin e Komisionit për zgjedhje dhe emërime. Seanca e Komisionit për zgjedhjet dhe emërime paraprakisht u shty njëherë sepse VMRO-DPMNE dhe BDI nuk kishin paraqitur propozime për anëtarë.

Lustrimi

Është paraqitur një kërkesë për qasje të lirë në informata publike të Komisionit për verifikimin e fakteve në lidhje me numrin e saktë të propozimeve për iniciativa të ngritura, por deri tani nuk ka përgjigje.¹⁷

Reforma zgjedhore

Ndryshimet e Kodit zgjedhor përfshijnë ndryshimet që janë rënë dakord në grupin e punës për zbatimin e Marrëveshjes të Përzahos.¹⁸

Shtohen dy dispozita të reja që ndalojnë përdorimin e hapësirës për zyrë, pajisje zyre dhe automjete zyrtare të autoriteteve publike për qëllime të fushatës zgjedhore dhe ndalohet kryerje ose përpjekjet për kryerje presion dhe frikësim i votuesve ose familjarëve dhe të afërmeve të tyre.

Nga dita e shpalljes të zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit, nuk mund të disponohet me mjete buxhetore, respektivisht të nisen ndërtime dhe të ndahen paga, pensione, ndihma sociale dhe pagesa jashtë pagesave të rregullta. Në periudhën prej 20 ditë para fillimit të fushatës zgjedhore deri në përfundim të zgjedhjeve ndalohet shpërndarja e subvencioneve që nuk paraqesin pagesa të rregullta mujore si dhe organizimi i ngjarjeve publike që shënojnë fillimin e ndërtimeve ose lëshimin në përdorim të objekteve publike.

Listën zgjedhore e mirëmban Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili është i vetmi subjekt përgjegjës për përditësimin e saj në bazë të kontrollit dhe analizave statistikore, verifikime të kryqëzuar të të dhënave dhe evidencave të ndryshme, kontrolle të pakufizuara në terren dhe metoda të tjera të pranuar të kontrollit.

¹¹ Monitorimi i aktiviteteve të Institutit të të Drejtave të Njeriut. Rregullorja do të analizohet më tej

¹² Takim i realizuar mes Këshillit Gjyqësor dhe delegacionit të Komisionit të Venecias. Faqja e internetit e KGJRM. 13.11.2015. Në dispozicion në: <http://www.ssrn.mk/Novosti.aspx?novosti=363>.

¹³ Takimi u ndoq nga Margarita Caca Nikolovski, kryetare e Institutit të të Drejtave të Njeriut

¹⁴ Vendimin mund ta gjeni në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"sort":\["kdate Descending"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-158137"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{).

¹⁵ Shpallja publike për pjesëmarrësit në trajnimin fillestar në Akademinë për gjykatës dhe prokurorë "Pavell Shatev". Faqja e internetit e AGJPP. E publikuar më 18.11.2015 (Botuar në Fletoren Zyrtare të 9.11.2015). Në dispozicion në: <http://www.ipacademy.gov.mk/novosti/-----30--->.

¹⁶ Si kryetar u zgjodh Peter Shilegov, nënkryetar Goran Misovski, ndërsa Antonio Milloshoski, Sillvana Boneva, Krsto Mukoski, Pavell Sazdov Dimitar Stevananhija Liljana Zaturaska Magdalena Manaskova, Vlladanka Aviroviq Tomislav Tuntev Vasko Kovaçevski, Talat Xhaferi, Ejup Rustemi, Ernad Fejzulla dhe Rosa Topuzova Karevska u zgjodhën si anëtarë të Komisionit.

¹⁷ Kërkesa është dorëzuar më 2 nëntor nga Instituti për të Drejtat e Njeriut

¹⁸ Për mënyrën e zgjedhjes së deputetëve nga diaspora, regjistrimin e votuesve, reklamën politike në shërbimin radiodifuziv publik dhe mediat private dhe përbërjen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve njoftuam shkurtimisht në brifingun e kaluar.

Në aspektin e përfaqësimit të barabartë të gjinive, të paktën 40% të kandidatëve i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar, domethënë: në çdo tre vende të paktën një do të jetë e rezervuar për gjininë më pak të përfaqësuar dhe gjithashtu të paktën një vend në dhjetë vende.

Nuk lejohet financimi i fushatës zgjedhore nga fondet buxhetore, fondet e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve publike. Ofrimi falas i shërbimeve, trajtohet si donacion. Pjesëmarrësi në fushatën zgjedhore mund të shpenzojë deri 180 denarë për votues të regjistruar në zonën zgjedhore, dhe për këtë paraqet një raport financiar i cili i nënshtrohet auditimit nga Zyra Shtetërore e Auditimit.

Në seancën e mbajtur më 16 nëntor, Parlamenti miratoi një vendim për publikimin e shpalljes publike për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.¹⁹

Depolitizimi i administratës publike

Ministri aktual i brendshëm, Oliver Spasovski më 12 nëntor ka dërguar një telegram punonjësve se "të gjitha kompetencat e dhëna nga Ministri i Brendshëm që kanë drejtuar dikasterin deri në sjelljen e vendimit në fjalë për zgjedhjen e anëtarëve të Qeverisë, nuk janë më në fuqi". Telegrami u transmetua fillimisht nga mediat pro-qeveritare, me tituj të cilit linin të kuptohet se në Ministri zotëron gjendje kaosi, ndodh shkelje e sistemit të sigurisë dhe paralizohet policia.²⁰ VMRO-DPMNE hodhi akuzën se ky veprim është politizimi i Ministrisë.²¹ Për shkak të këtyre reagimeve, Spasovski lëshoi një demant nga ana e Ministrisë së Brendshme.²²

Pas ardhjes në detyrë, **Ministre e Punës dhe Politikës Sociale**, Frosina Remenski Tashevska inkurajoi punonjësit dhe qytetarët të paraqesin çdo lloj presioni, veprim ose kërkesë të paligjshme nga ana e shefave të tyre. Zëvendës ministri plotësues Spasov dërgoi një letër duke kërkuar nga punonjësit të mos veprojnë sipas njoftimit të dërguar nga ministri i ri, për shkak se është i paligjshme dhe "paraqet një përpjekje të hapur për politizimin e institucioneve dhe shkelje të të drejtave dhe lirive të qytetarëve."

Sipas **amendamenteve të Kodit Zgjedhor**, partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor duhet të firmosin Kodin për zgjedhje të ndershme që i detyron qartë t'i shmangen çdo lloj presioni apo përpjekje për të bërë presion mbi të punësuarit në administratën publike dhe shtetërore, si dhe mbi shoqëritë tregtare dhe kompanitë me kapital shtetëror.

Media

Lidhur me raportin e KE mbi lirinë e shprehjes, **Shoqata e Gazetarëve (SHGM)** beson se raporti është më kritikë, por edhe më realisti deri tani.²³ **Asociacioni Maqedonas i Gazetarëve (AMG)**, ndërkohë, e hodhi poshtë atë si të njëanshëm dhe subjektiv.²⁴

Pak para takimit të partive politike, u organizua një takim i gjerë në mënyrë që të dëgjohen pikëpamjet e sektorit të mediave dhe OJQ-ve. Sipas deklaratës të lehtësuesit Vanhaute, reforma e mediave ka të bëjë me tetë pikë: eliminimin e dhunës ndaj gazetarëve, qasje të lirë në informacion, shmangie e denoncimeve për shpifje, rishqyrtim i reklamimit politik dhe qeveritar, vetë-rregullimi i mediave përmes këshillave etik dhe ndryshime në Agjencinë për shërbime audio dhe audio-vizuale, në Agjencinë Informativë të Maqedonisë dhe Shërbimit Publik. Nga partitë politike, vetëm LSDM dhe PDSH morën pjesë në debat. Afati i fundit për arritjen e një marrëveshjeje është zgjatuar për një javë ose deri më 27 nëntor 2015.

Sipas amendamenteve të Kodit Zgjedhor,²⁵ **Agjencia për media audio dhe audio-vizuale** më 12 nëntor ka dërguar një njoftim për mediat se ndalohet transmetimi ose publikimi i reklamave të financuara nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe të gjithë personat e tjerë që me ligj janë ngarkuar me kryerjen e funksioneve publike.²⁶ Pas kësaj deklarate, shërbimi i transmetimit publik më 13 nëntor ndaloi publikimin e fushatave reklamuese qeveritare të financuara nga buxheti. Duke pasur parasysh faktin se ndryshimet në Kodin Zgjedhor hynë në fuqi më 10 nëntor, njoftimi dhe vendimi erdhën me një vonesë prej dy, respektivisht tre ditë. Transmetuesit, mediat

¹⁹ Në dispozicion në: <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialid=d7698074-2202-4ae8-9c11-8f09c678dc14>.

²⁰ Mes reagimeve të para, ishte edhe ai i ish-ministres për punë të brendshme, Gordana Jankulovska, e cila përmes profilit të saj twitter, paralajmëroi se shteti është rrezikuar.

²¹ LSDM-ja nuk pati durim as dy ditë, dhe tashmë na tregoi se si do ta politizojë Ministrinë e Brendshme. Faqja e internetit e VMRO-DPMNE 13.11.2015 Në dispozicion në: <http://vmro-dpmne.org.mk/?p=28328>.

²² Demant lidhur me telegramin në fjalë Internet faqja e MPB-së 13.11.2015. Në dispozicion në: <http://www.znm.org.mk/vest/807>.

²³ ShGM Raporti i KE-së kritik por realist Internet faqja e ShGM. 12.11.2015. Në dispozicion në: <http://www.znm.org.mk/drupal-7.7/mk/node/927>.

²⁴ AMG: Raporti i KE në lidhje me mediat është i njëanshëm Telma. 10.11.2015. Në dispozicion në: <http://www.telma.com.mk/vesti/manizveshtajot-na-ek-vo-delot-na-mediumite-e-pristrasen>. AMG nuk ka faqe interneti

²⁵ Neni 83 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Zgjedhor. Nga data e hyrjes në fuqi të këtij Kodi në datën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, që do të mbahen më 24 prill, 2016, transmetuesit, mediat e shkruar dhe mediat elektronike (portale interneti) nuk mund të transmetojnë ose publikojnë reklama të financuara nga buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit dhe të gjithë personat e tjerë që me ligj janë të ngarkuara me funksione publike.

²⁶ Komunikatë për shtyp Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale Faqja e internetit e AMAAV. 12.11.2015 Në dispozicion në:

http://avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=2473%3A2015-11-12-14-56-22&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk

e shkruara dhe mediat elektronike, si dhe subjektet e tyre përkatëse në asnjë mënyrë nuk lejohen të financojnë apo t'u japin donacione partive politike.

Organizatat e mediave reagues ndaj ndryshimeve në Kodin Zgjedhor të cilat parashohin rritjen e gjobave për mediat dhe zgjerimin e përfshirjes me portalet e internetit, dhe kërkojnë që të përfshihen në procesin e negociatave. Në të kundërtën, ata paralajmëruan protesta përpara Klubit të deputetëve, bojkotin e vendimeve të dala nga negociatat si dhe zgjedhjet.²⁷

Në prani të shoqatave profesionale, Agjencisë për mediat dhe lehtësuesit Vanhaute, udhëheqësia e RTVM-së më 17 nëntor prezantoi **Kodin e Etikës së shërbimit publik**. Ky vendim u kritikua nga SHGM, duke e vlerësuar si zgjidhje politike

²⁷ Organizata mediatike: Dënimet për mediumet në Kodin Zgjedhor janë skandalozë NOVA TV 20.11.2015 Në dispozicion në: <http://novatv.mk/index.php?naviq=8&cat=2&vest=25689>.

REAGIME

Në adresën tonë elektronike më 10.11.2015, sërish arriti reagim nga zëdhënësja e Gjykatës së Lartë, të cilën e japim në tërësi.

Në të njëjtën kohë, shprehim kënaqësinë tonë se fjalimi i përmendur i Kryetares së Gjykatës së Lartë është publikuar në faqen e internetit të Gjykatës dhe lexuesit e interesuar mund ta lexojnë në tërësi.²⁸

Teksti i reagimit:

Të nderuar,

Ju falënderoj për raportin tuaj me titull "Monitor: Zbatimi i reformave prioritare urgjente" për periudhën nga 10.21.2015 deri më 11.06.2015, i dorëzuar me e-mail më datë 09. 11. 2015 në ora 18. 00.

Në arsyetimin e raportit tuaj, sërish sqaroni se Rrjeti 23- rrjeti i OJQ-ve, i themeluar në korrik të vitit 2015, aktualisht ndjek reformat prioritare urgjente, mbështetur nga Holanda, dhe raportet e saj janë të bazuara në hulumtime dhe avokime në bazë të provave dhe argumenteve.

Në pjesën me titull "Sundimi i ligjit dhe gjyqësia", në faqen e tretë të raportit tuaj thuhet "Në fjalën e saj përshëndetëse, kryetarja Lidia Nedellkova tha se edhe pse gjyqësori në Maqedoni po ballafaqohet me probleme dhe dobësi që duhet të tejkalohen, perceptimi i opinionit publik për gjyqësorin më tepër bazohet në kritika arbitrare të **drejtuara nëpërmjet dhe nga mediat.**"

Në këtë kontekst, për ne është e papranueshme që në raportin të qëndrojë pjesa ku thuhet "drejtuara nëpërmjet dhe nga mediat" për shkak se kjo nuk është pjesë e fjalimit të kryetares të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë gjatë Akademisë solemne më 29 tetor 2015, ku asnjëherë nuk përmendet fjala media, madje as konteksti i fjalimit nuk i referohet kritikave nëpërmjet dhe nga mediat.

Sërish theksojmë se mendimet personale dhe komentet arbitrare nuk mund të jenë bazë mbi të cilën e përgatitni këtë raport, të cilin thonë se e bëni duke u bazuar në hulumtime dhe avokime në bazë të provave dhe argumenteve.

Fjalimin e Kryetares së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë Lidia Nedellkova mund ta shkarkoni nga faqja e internetit e Gjykatës Supreme "www.vsrn.mk", pjesa njoftime për shtyp, në kuadër të njoftimit për shtyp lidhur me Akademinë solemne me rastin e shënimit të 70 vjetorit nga themelimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë të mbajtur më 29 tetor 2015. Për këto arsye, ne dërgojmë këtë tekst si vërejtje nga ana jonë, që dëshirojmë të merret parasysh."

²⁸ Në dispozicion në: http://www.vsrn.mk/cms/FCKEditor_Upload/File/%D0%93%D0%BE%D0%B2%D0%BE%D1%80-70%20%D0%B3%D0%BE%D0%B4%D0%B8%D0%BD%D0%B8.pdf.